



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKI
Dep. DPKI
Nr. I faq 02
Broj stranica 02
Nr. pages 02

Nr. Prot. 03-02/3889/16
Data 20.10.2016
PRISHINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.10.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2783/16, për zyrtarin e lartë z. Lulzim Rustemi, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2783/16, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Lulzim Rustemi, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim në funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë, z. Lulzim Rustemi, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit figuron si person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Lulzim Rustemi, ka ardhur në takim, ku nga zyrtarët e AKK-së është njoftuar me faktet dhe provat që posedon AKK-ë lidhur me çështjen e iniciuar për konflikt të interesit.

Gjatë takimit që është mbajtur në zyrat e AKK-së me z. Rrustemi, ai është pajtuar me faktet e prezantuara dhe është deklaruar se në biznesin ku ai figuron si person i autorizuar dhe bashkëpronar do të ndërmerr të gjitha veprimet dhe do të heqë dorë nga funksioni i personit të autorizuar në këtë biznes .

Me datën 18.10.2016 nga z.Lulzim Rrustemi, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se në Biznesin me nr.71179915 dhe me emër "ORBITA" sh.p.k, z. Lulzim Kryeziu nuk figuron me si person i autorizuar i këtij biznesi.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Lulzim Rrustemi, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, duke u larguar nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mospajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

